

## MENDIM PARALEL

Unë, Lulzim Hamitaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Herila Çela, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë – duke mbështetur vendimmarrjen përfundimtare për shkarkimin e saj nga detyra, por duke mos qenë dakord me një pjesë të konsiderimeve dhe qëndrimeve të mbajtura nga të dy anëtarët e tjerë të trupit – në vijim po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe ndaj arsyetimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me: (i) pamjaftueshmërinë e disa rrethanave/konkluzioneve në kriterin e pasurisë, për aplikimin e nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016; (ii) pamjaftueshmërinë e elementeve të tjera, që do të mund të justifikonin/legjitimonin aplikimin e nenit 61, pika 5 e dispozitës së lartpërmendur.

1. Nisur nga fakti që në fund të analizimit të pasurisë nr. 4, konkretisht në pikën 4.26 të vendimit *de quo* (nr. 710, datë 30.10.2023), është konkluduar se: “[...] subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.000.000 lekë për krijimin e depozitave pranë OTP Bank në vitin 2006, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 [...]”, vërej se në rrethanat dhe faktet përballë të cilave gjendemi, sipas vlerësimit tim lidhur me depozitën e lartpërmendur duhej të konkludohej për mjaftueshmërinë e burimeve financiare. Konkretisht, konkluzioni im mbi mjaftueshmërinë e burimeve bazohet në kombinimin dhe vlerësimin e harmonizuar të fakteve dhe rrethanave të mëposhtme:
  - a. Pretendimi mbi realizimin e të ardhurave prej nënës së subjektit në vlerën 1 milion lekë, si paradhënie nga shitja e tokës në shtator 2006 – ndonëse nuk është i provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm – duket bindës për sa kohë:
    - i. Toka në fjalë, edhe pse ishte përfituar me një vendim gjyqësor të datës 30.6.2003, është regjistruar në emër të palës shitëse (nënës së subjektit) vetëm më datë 8.1.2007;
    - ii. Në këto kushte duket e mundshme që pas fitimit të pronësisë dhe në prag të regjistrimit të saj palët mund të përfshiheshin (në) negociime mbi një shitblerje për ta formalizuar më tej, duke u impenjuar (në mirëbesim) nëpërmjet paradhënies së një pagese (kapari).
    - iii. Mungesa e certifikatës së pronësisë në emër të palës premtuese shitëse nuk e mundësonte formalizimin e kësaj marrëveshjeje nëpërmjet një kontrate të mirëfilltë premtim shitjeje.
  - b. Arkëtimi i shumave në fjalë nuk është kryer nga subjekti, por nga një person jodeklarues. Kësisoj, niveli i tolerimit mbi mungesën e formalitetit (noterial) në atë kohë duhet të jetë më i lartë dhe fleksibël në funksion dhe përputhje me rrethanat specifike – për sa kohë bëhet fjalë për një marrëdhënie mirëbesimi mes të tretësh, që nuk duhet të penalizojë subjektet e rivlerësimit për mungesa formale që passjellin edhe vështirësinë e shtuar të të provuarit.
  - c. Mandatarkëtimi i datës 17.9.2006 – ndonëse jo origjinal dhe i paraqitur përgjatë procesit të rivlerësimit e, kësajsoj, me një vlerë provuese të cunguar – nuk mund të përjashtohet *a priori* nga vlerësimi në tërësi i rrethanave në analizë.
  - d. Gjithashtu, arsyetimi i mësipërm (në shkronjat “b” dhe “c”) duhet të mbahet në konsideratë edhe për sa i përket vlerës provuese të deklaratës noteriale të datës 15.7.2023 të shtetasit L. N., si një mjet provues që jo domosdoshmërisht do të duhej të ishte siguruar përpara nisjes

së procesit të rivlerësimit nga nëna e subjektit apo (aq më pak) nga vetë subjekti i rivlerësimit.

**1.1** Nisur nga sa më lart, duke i parë në tërësinë e tyre faktet e përshkruara më sipër – të cilat përputhen në mënyrë komplementare (ndër plotësuese) mes tyre – krijohet bindja se depozita në analizë është formuar edhe me disponimin dhe përdorimin e shumës 1 milion lekë, të përfituar në shtator 2006, në formë kapari. Në këto kushte, nga ana ime lidhur me këtë pasuri/depozitë nuk gjenden shkaqe penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

**2.** Gjithashtu, nuk ndaj të njëjtin mendim për sa i takon konkluzionit të arritur në pikën 11.25 të vendimit në fjalë, ku konkretisht citohet se: “[...] subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në periudhën 1997 – 2003, në shumën 848.073 lekë, për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. [...]”.

**2.1** Qëndrimi im ndryshe në këtë rast lidhet me faktin se nuk jam dakord me këtë konkluzion penalizues për subjektin, për sa kohë konstatimi i pamjaftueshmërisë financiare përlllogaritet nëpërmjet një marzhi fitimi hipotetik, të pabazuar në ndonjë të dhënë konkrete të rastit specifik apo në dokumentacion zyrtar vlerësues dhe/ose statistikor nga bilancet, apo nga përpunimi i këtyre të dhënave nga organet kompetente<sup>1</sup> ose nga jurisprudenca e organeve të vetiug-ut. Konkretisht, referuar pikës pararendëse (11.24) të këtij vendimi, vlerësoj se marzhi i aplikuar prej 20% mbi qarkullimin e shoqërisë M. O. sh.p.k., duke mos qenë një e dhënë statike, por thjesht hipotetike, nuk mund të përcaktojë në mënyrë të prerë një masë të caktuar pamjaftueshmërie financiare. Nëse ky marzh fitimi do të ketë qenë shumë më i lartë se 20% (sikurse pretendon subjekti), atëherë do të gjendeshim përballë një rëndimi të pabazuar të pozicionit të subjektit. Në këto kushte, unë vlerësoj se në rastin në fjalë nuk është kristalizuar ndonjë pamundësi financiare reale mbi të dhëna konkrete të përpunuara nga organe/burime të treta, por thjesht marzhi i fitimit është hipotizuar. Për më tepër, vlen të theksohet se në këtë pikë nuk përlllogariten të ardhurat e vetë subjektit apo të familjes së saj, pasi bëhet fjalë për të ardhura të realizuara nga bashkëshorti (i ardhshëm) në vitet 2001 e 2002, përpara martesës së këtij të fundit me subjektin e rivlerësimit. Kësisoj, ky konstatim nuk mund të prodhojë efekte penalizuese për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë çmoj se në këtë rast nuk ka fakte të mjaftueshme që të plotësohen kushtet e aplikimit të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**3.** Veç sa më sipër, nuk bie dakord as me konkluzionin e arritur nga të dy anëtarët e trupit gjykues lidhur me blerjen e automjetit tip “Chevrolet” nga ana e bashkëshortit të subjektit. Konkretisht nuk ndaj të njëjtin mendim për sa i takon konkluzionit në pikën 15.21 të këtij vendimi, sipas të cilit: “[...] subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.890.000 lekë për blerjen e automjetit tip “Chevrolet”, në datën 14.1.2012, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016”.

**3.1** Qëndrimi im ndryshe konsiston në faktin që vlerësimi i mjaftueshmërisë (ose jo) të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie nuk mund të anashkalojë një analizë logjiko-faktike, e cila të çon sipas meje në konsiderimin (dhe përlllogaritjen në analizë financiare) e

---

<sup>1</sup> Si p.sh. Drejtoria Tatimore respektive apo Ministria e Financave, etj.

përdorimit të një mase burimesh të ligjshme të disponuara në vitin 2011, si të përdorura për blerjen e automjetit tip “Chevrolet” nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**3.2** Konkretisht, sikurse është trajtuar edhe në pjesën përkatëse të vendimit, bëhet fjalë për një porosi të këtij automjeti më 7.12.2011 pranë një shoqërie të autorizuar, “N.” sh.p.k, ndërkohë që ka rezultuar se pas porositjes kjo shoqëri e ka blerë automjetin në analizë jashtë vendit dhe më 21.12.2011 ka paraqitur deklaratën doganore përkatëse dhe e ka dorëzuar mjetin në datën 14.1.2012, datë në të cilën është lëshuar edhe fatura tatimore përkatëse. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se në vitin 2011 familja e subjektit ka pasur një disponibilitet financiar me burime të ligjshme, pothuajse të mjaftueshëm për të paguar çmimin e kësaj pasurie. Ndërkohë që, ndonëse subjekti ka pretenduar se pagesa për këtë pasuri është kryer në momentin e porositjes, 7.12.2011 – nisur nga mosdeklarimi i këtij shpenzimi në deklaratën për vitin 2011 dhe nga mungesa e ndonjë fature lidhur me parapagimin – nga shumica është vlerësuar që e gjithë shuma e paguar për këtë automjet (13.500 euro) të përllorarit si e paguar në momentin e faturimit nga shoqëria shitëse, konkretisht më 14.1.2012, duke konstatuar mungesën e burimeve të ligjshme për vlerën totale të çmimit *de quo*.

**3.3** Nisur nga sa më lart, vlerësoj se nëse do të bëhej një vlerësim i ngushtë (*stricto sensu*), me fokus vetëm tek mosdeklarimi i shpenzimit nga subjekti në momentin e duhur për vitin 2011 dhe tek mungesa e administrimit të ndonjë fature lidhur me parapagimin e pretenduar, edhe nga ana ime do të vlerësohej korrekt konstatimi i pamjaftueshmërisë totale në datën 14.1.2012, por ky qëndrim nuk do të ishte gjithëpërfshirës dhe në harmoni me tablonë e përgjithshme. Kjo pasi: (i) praktika e parapagimit të çmimit të sendit/mjetit të porositur (apo së paku të një pjese të tij) është e njohur dhe bindëse, për më tepër që në rastin konkret – sikurse është provuar – vetë shoqëria e ka blerë mjetin *de quo* pasi është kryer porosia (dhe pagesa e pretenduar); (ii) përpos praktikës së gjerë dhe mirëbesimit mes palëve, distanca e shkurtër kohore (disa javore) midis porosisë dhe dorëzimit të mjetit së bashku me faturën tatimore përkatëse, e bën të besueshme tezën e parapagimit, për sa kohë porositësi nuk do të privohej për një kohë të gjatë nga shuma përkatëse, ndërkohë që shoqëria *de qua* nuk do të përdorte disponibilitet e veta financiare (*non expedit*) për blerjen e një mjete që do të dorëzohej shumë shpejt tek blerësi; (iii) edhe nëse ka pas një mandatarkëtimimi (*pro tempore*) apo faturë lidhur me parapagimin, ajo mund të jetë konsideruar e panevojshme për ta ruajtur, për sa kohë është zëvendësuar me një faturë tatimore të mëpasshme; (iv) lëshimi i faturës tatimore në momentin e dorëzimit të mjetit, jo vetëm që plotësonte nevojën formale të shoqërimit të automjetit me dokumentacionin e prejardhjes/origjinës, kënaqte edhe pasqyrimin e shitjes në bilancin e vitit të dorëzimit (2012) – përpos dobisë së mundshme edhe në aspektin e detyrimeve tatimore të vetë shoqërisë shitëse, që shitja të reflektohej në vitin 2012 e jo në atë pararendës; (v) distanca tejet e shkurtër kohore (dyjavore) midis disponibilitetit financiar me burime të ligjshme në fund të vitit 2011 dhe momentit të dorëzimit të automjetit dhe lëshimit të faturës fiskale (në mungesë të ndonjë prove të shpenzimit të shumave të kursyera brenda vitit 2011), përpara datës së faturimit (14.1.2012) e bën joreal dhe bindës konstatimin se një familje – ndonëse i kishte mjetet financiare në dhjetor të vitit 2011 – rezulton me një pamundësi totale për një blerje (qoftë edhe) të kryer më 14.1.2012; (vi) gjithashtu, jologjik dhe vetëndëshkues do të ishte veprimi i një familjeje që, edhe pse ka detyrimin për të deklaruar burimet financiare të çdo investimi dhe/ose shpenzimi të kryer (në cilindo vit), të kryejë një pagesë të rëndësishme pikërisht në datën 14.1.2012, kur

ende nuk kanë përfituar as pagesën e parë mujore për këtë vit – për më tepër duke e dokumentuar me faturë fiskale këtë veprim juridiko-financiar.

- 3.4** Kësisoj, nga vlerësimi i gërshetuar i rrethanave faktike të lartpërmendura çmoj se përjashtimi i mundësisë (dhe, për pasojë, mospërlllogaritja) që për blerjen e këtij automjeti të jenë përdorur edhe mjetet financiare të provuara si të ligjshme dhe të disponueshme nga familja e subjektit në fund të vitit 2011, do të përbënte një penalizim të sforcuar për subjektin e rivlerësimit, jo në përputhje me një vlerësim harmonik të fakteve, rrethanave, kontekstit, segmentit kohor dhe dinamikës në të cilën janë zhvilluar dhe konkluduar negociatat midis blerësit dhe shoqërisë shitëse të automjetit *de qua*.
- 3.5** Në këto kushte, dhënia përparësi e vlerësimit *stricto legis*, pa e konsideruar në tërësinë e vet rastin konkret, për mendimin tim do të binte ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit në raport me këtë pasuri (marrëdhënie juridiko-financiare), duke e penalizuar subjektin nëpërmjet moskonsiderimit të alternativës faktike (pagesës së kryer në dhjetor 2011). Për sa kohë nuk mund të përjashtohet kjo alternativë, vërehet se në çdo rast, edhe nëse në momentin e porosisë do të ishte paguar gjysma apo një pjesë e çmimit, kjo do të zvogëlonte pamundësinë e konstatuar në janar të vitit 2012, duke e zbehur kësisoj edhe nivelin e përgjegjësisë së subjektit e, për rrjedhojë, duke e përjashtuar mundësinë e marrjes së një mase ndaj subjektit lidhur me këtë pasuri, nëpërmjet aplikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Gjithsesi, edhe duke e konsideruar të gjithë pamundësinë financiare për krijimin e këtij automjeti – në vlerën që është konstatuar në vendimin *de quo* – mendoj se duke mbajtur në vëmendje sa më lart është arsyetuar, nuk do të ishim përballë një situatë për të cilën do të gjente aplikim dispozita penalizuese e lartpërmendur në raport me këtë pasuri.
- 4.** Po ashtu, ndaj mendim ndryshe edhe lidhur me konkluzionin e pikës 17.61, sipas të cilit: “[...] subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.129.846 lekë për krijimin e depozitave pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe pranë Union Bank, pasi: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.100.000 lekë për kryerjen e depozitimit në datën 18.5.2004; (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën 1.029.846 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. [...]”. Kjo pasi edhe ky konstatim derivon nga mënyra e përlllogaritjes hipotetike, për sa kohë i referohet burimeve (të krijuara në origjinë pjesërisht para martese) të realizuara nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet shoqërisë “M.” sh.p.k., lidhur me marzhin e fitimit të së cilës e kam shprehur qëndrimin tim ndryshe në pikën 2 të këtij mendimi paralel, të cilit i referohem edhe në raport me këtë konkluzion. Kësisoj, mendoj se ky konstatim, si për nga mënyra e përlllogaritjes, ashtu edhe për masën e pamjaftueshmërisë (hipotetike), nuk mund të prodhojë efekte penalizuese për subjektin e rivlerësimit.
- 5.** Së fundmi, ndaj mendim ndryshe edhe për sa i përket qëndrimit të shprehur në vendim lidhur me aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, konkretisht në konkluzionet përfundimtare, shkronja “d”, pasi në vlerësimin tim – ndonëse qëndron konstatimi i përfitimit të të ardhurave nga shoqëria “M.” sh.p.k. nëpërmjet lidhjes së kontratave të shërbimit me institucione publike, në kushtet e konfliktit të interesave – kjo rrethanë nuk përbën në vetvete shkak të mjaftueshëm për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, pasi:

- a. Ky lloj konflikti interesash nuk lidhet me vlerësimin e aftësive profesionale apo me etikën e vetë subjektit në raport me dosje të shqyrtuara nga subjekti në konflikt interesi me palët e çështjes/ve në proces, por me përfitimin financiar të një pjese të vogël të të ardhurave të gjeneruara (në konflikt interesi) nga shoqëria, ku ishte ortak (dhe jo administrator) bashkëshorti i subjektit.
  - b. Kontratat e shërbimit nuk janë nënshkruar nga subjekti, as nga bashkëshorti i saj e, për rrjedhojë, nuk mund të merret e mirëqenë dijenia e subjektit për lidhjen e këtyre kontratave të shërbimit.
  - c. Pësia specifike e këtyre shërbimeve me institucione publike zbehet edhe më shumë nga momenti që e njëjta shoqëri ka lidhur kontratë dhe i ka ofruar shërbime edhe vetë organit kontrollues të konfliktit të interesave (ILDKPKI).
  - d. Masa e përfituar nga këto kontrata ka qenë minimaliste në raport me të ardhurat e gjeneruara nga shoqëria "M." sh.p.k., kështu, nëse do të kishin dijeni mbi gjendjen e konfliktit të interesit (për më tepër me pasojat penalizuese deri në shkarkimin e subjektit), do të ishin shmangur këto marrëdhënie, pa ndikuar në mënyrë përcaktuese në bilancet e shoqërisë *de qua*.
6. Në konkluzion, në këndvështrimin tim, i vetmi konstatim penalizues për subjektin e rivlerësimit, znj. Herila Çela, mbetet ai i kristalizuar në pikën 20.6.24 të vendimit, për shkaqet e përshkruara (aty) në pikat pararendëse dhe me këtë përmbajtje: "[...] subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk paraqitën dokumentacion ligjor justifikues lidhur me shumën 9.968.097 lekë, shtuar në vitin 2010, duke u gjendur në kushtet e shkronjës "b", pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar krijimin e kësaj shume [...]".

**Anëtar i trupit gjykues**  
**Lulzim HAMITAJ**